

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 182, Dhjetor 2018
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

KARTOLINA E KRISHTLINDJES DHE VITIT TË RI!



2019

Të dashur dukagjinas dhe dukagjinase dhe dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinaseve kudo që ndodheni!

Ndoshta disa prej jush do keni mundësinë të keni në duar Gazetën Dukagjini e ndoshta shumë të tjerë jo por të paktën ne po dëshirojmë dhe urojmë që kjo kartolinë të jetë në duart e secilit prej jush.

Festa e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri na kujtojnë që është koha e vitit në të cilën ne ndalemi për të pyetur sesi po shkojnë me jetën tonë. Është pak a shumë arbitrare ku ne shënojmë fundin e vitit, por për shkak se konventë ndahet me

të tjerët, jeta jonë ka një ritëm që shënohet nga kalendari dhe kohëzgjatja e vitit e bën atë një njësi të mirë për vlerësimin e disa aspekteve të jetës tonë. Mund të pyesim nëse i mbërthehem rezoluteve të bëra 12 muaj më parë. Ne mund të pyesim rreth mënyrës se si po shkon jeta jonë: a kemi qenë persona, prindër apo partnerë të mirë? A i kemi ndjekur qëllimet e vlefshme? A kanë qënë të mirëprojektuar hapat që kemi ndërmarrë drejt këtyre synimeve?

Jeta e pakontrolluar nuk vlen të jetohet, e ka thënë Sokrati me famë botërore. Kohët e fundit, Mill i bëri jehonë Sokratit, duke

argumentuar se ishte më mirë të jetosh një jetë vet-reflektimi dhe të jesh i pakënaqur sesa të jesh një derr që nuk reflektonte të ishte i lumtur.

Ideja që ne mund të reflektojmë në jetën tonë dhe trajektoret e tyre mbetet shumë tërheqëse për ne dhe gjen shprehje edhe në qasje psikologjike dhe në libra për vetë ndihmë.

Ideja se ne mund të reflektojmë dhe sërish të ndërtojmë objektiva të cilat nuk kemi mundur ti realizojmë gjatë këtij viti, mund të jetë ndihmuese për këndvështrimin tonë dhe vizionin që kemi në shtrirjen kohore të vitit vijues.

Prandaj ta mendojmë Krishtlindjen, një lindje plot me shpresë, me besim dhe dashuri për një jetë më të mirë, e plot mirëkuptim me njëri-tjetrin.

Ta mendojmë Vitin e Ri një fillim të ri e të freskët., si një kapitull të ri që është duke pritur për tu shkruar, me pyetje dhe sfida të reja. Nga ana tjetër me përgjigje që presin për tu zbuluar dhe për tu jetuar në një vit transformative. Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri!

REDAKSIA
E GAZETËS
"DUKAGJINI"

REALIZIMI I VEPRIMTARIVE TË VITIT, NJË BAZË E MIRE PËR VIJIMIN E REALIZIMIT TË MISIONIT TË SHOQATËS PËR VITIN 2019



Viti 2018, me punën e anëtareve të shoqatës, të anëtareve të kryesisë po mbyllet me shumë realizime, të planifikuara për këtë vit.

Së pari, me punën e palodhur të anëtareve të redaksisë, me në krye Luigj Shytin, të dashamirësve të gazetës “Dukagjini”, dhe të mundësorëve, gazeta edhe këtë vit ka dalë rregullisht në çdo muaj. Në këtë muaj del numri 182 i saj. Për botimin e gazetës kanë kontribuar Gjergj Leqejza për pesë numra, Ndue Ftoni për tre numra, Gëzim Çardaku për tre numra dhe Anton Kosteri për një numër, të cilët i falënderojmë, Zoti ju shtoftë “inatin” dhe të vijoni të mundësoni botimin e gazetës.

Së dyti, kemi marrë pjesë duke qënë edhe organizator, në disa veprimtari:

*Me datën 6 – 10 Prill 2018, morëm pjesë në Manifestimin “Zëri i Vëllazërisë-2018”, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastrioti. Me datën 6 prill ishim në Lezhë, te Memoriali i varrit të Gjergj Kastriotit. Po atë datë ishim në Hot në kuadrin e 107 vjetorit të Kryengritjes antiosmane dhe të ngritjes së Flamurit Kombëtar në malin e Deçitit, pranë lapidarit kushtuar kësaj kryengritje.

*Me datën 7 Prill, në mjedisin e bibliotekës së “Luigj Gurakuqi” organizuam paraqitjen e monografisë kushtuar Profesor, Kolë Prelës, me titull “Profesor Kole Prela, deputeti historik i Dukagjini”, me autor Prelë Milanin, me pjesëmarrje nga gjitha trevat shqiptare. Me këtë rast nga Sekretarja e Prefekturës u dorëzua, zonja Feleke Kasemi, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes “Mirënjohja” për profesor Kolë Prelën, si pjesëmarrës në Luftën Nacional-Çlirimtare. Me këtë rast dhe Prelë Milanin, nga kryesia e Shoqatës, u nderua me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”. Me datën 9 Prill ishim në Rrafshin e Dukagjinit, në Deçan, bëmë homazhe në varrezat e Dëshmorëve në Gllogjan, në qendër të qytetit, te komuna u zhvillua një koncert i përbashkët festiv. Këtu nderuam me titullin “Mehmet Shpendi” luftëtarët Tahir Selim Geci dhe Lan Selim Geci.

*Me datën 10 Prill ishim në Prekaz, ne nderuam të rënë në Luftën e Kosovës nga familja e Adem Jashari dhe pasi bëmë nderimin e vendosëm lule, shkua në shtëpinë e Adem Jasharit, ku na priti Rifat Jashari. Rreth drekës së kësaj date, bëmë homazhe pranë monumentit madhështor të Adem Jasharit, në qendrën e Komunës Skenderaj dhe pastaj morëm pjesë në koncertin, që u dha me këtë rast i organizuar nga seksioni i kulturës së kësaj komune. Nderuam titullin “Mehmet Shpendi” bashkëluftëtarin e Azem Galicës, Shaban Mangjollim.

Në të gjitha rastet u bën përshëndetje në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Shoqata u nderua me titullin “Mirënjohja”, nga shoqata “Martin Dreshaj” për pjesëmarrjen në këtë manifestim.

Ata, që mundësuan marrjen pjesë në këtë manifestimin “Zëri i Vëllazërisë-2018”, janë Ndue Ftoni, me banim në Miçigan, Preke Nike Gjonaj, me banim në Kanada, Gjergj Leqejza, Prele Milani e Mikel Shpatina, si dhe zonja File Strugaçi. të cilët i falënderojmë dhe i urojmë me shprehjen popullore “Paçin e dhënçin!”.

*Me datën 15 prill morëm pjesë në takimin për rrugën e Dukagjinit, të organizuar nga Gjon Dukgilaj dhe i mundësuar nga Ndue Ftoni e Gjon Dukgilaj, me pjesëmarrjen jo vetëm banore të Dukagjinit, por dhe artist e shkrimtar të qytetit të Shkodrës.

*Me datën 13 maj 2018, organizuam festën e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në mjediset e Fshatit të Paqes, me pjesëmarrjen e shumë anëtarëve, aktivistëve dhe veprimtarëve të Shoqatës, por dhe shumë miqve, përfaqësues të shoqatave analoge, si: Të shoqatës “Martin Dreshaj” me qendër në Pejë; të Ansambllit folklorik autokton “Rugova”; të Muzeut “Ivezaj” në Tuz; Klubi i Shkrimtareve në Klinë; Shoqata “Bytyçi-Tiranë – Prizren”; Shoqata “Sali Mani”; Shoqata Kulturore e Atdhetare “Postriba” dhe të teatrit “Aleksandër Moisiu” në Pejë. Në mes tyre, e veçantë ishte pjesëmarrja e Monsinor Angelo Massafra, e nënkryetarit të Bashkisë Shkodër, z. Arben Gjuraj dhe e z. Filip Guraziu, anëtar i Këshillit të Bashkisë Shkodër. Në këtë festim u nderuan me tituj nderi: me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, Imzot Monsinor Angelo Massafra, zoti, Flamur Gashi, zoti, Arben Gjuraj dhe zonja, Prenda Mark Shpendi; me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, u nderua zoti Petro Koçi dhe zoti Kolë Çardaku; me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”, zoti Tonin Vasa; me titullin “Mehmet Shpendi”, Tulan Lulashi dhe Martin Gjon Gilaj, pas vdekjes; me

titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Fadil Galiqi, Dukate Bregu, Besim Zagani, Nikoll Hebja e Lek Mirash Nika – pas vdekjes, Sose Nika Shqau, Kin Kola, Simon Zhuri, Marie Buxha dhe Drita Zefi.

Me rastin e kësaj feste për të pranishmit u dha koncert dhe u bë parada e veshjeve tradicionale të Dukagjinit, nen kujdesin e Luigj Mila, Roza Pjetri e Gjon Dukgilaj.

Në këtë festim pati përshëndetje nga miqtë dhe dhënie të titujve nderi: Përshëndeti: Drejtori i Ansambllit “Rugova”, zoti Vesel Nikçi, i cili në emër të këtij ansambli dorëzoi titullin “Mirënjohja” për shoqatën, për Kryetarin e Shoqatës-Ndue Sanaj dhe për Zef Lulash Sokolin, pas vdekjes; Klubi i Shkrimtarëve në Klinë, zoti Prend Buzhala dhe zoti Ismet Krasniqi-Lala, të cilët nderuan me titullin “Mirënjohja” Kryetarin e Shoqatës, Ndue Sanaj; zoti Rrahman Jashari përshëndeti në emër të Shoqatës “Martin Dreshaj” dhe zoti Ukshin, Shoqatës i dhe titullin “Mirënjohja”; zoti Fadil Grabovci, përshëndeti në emër të Teatrit “Aleksandër Moisiu” dhe nderoi me titullin “Mirënjohja” shoqatën; përshëndeti zoti Shtjefen Ivezaj, në emër të Muzeut “Ivezaj” dhe nderoi shoqatën me titullin “Mirënjohja” dhe Agron Isa Gjedi, përshëndeti në emër të shoqatës “Bytyçi”-Tiranë-Prizren dhe kryetarin e shoqatës, Ndue Sanaj e nderoi me çmimin “Plisi i bardhë, emblema hyjnorë e shqiptarisë”, i klasit të parë.

Ky festim u mundësua nga dukagjinasi Prek Gjonaj, Sokol Sterbyçi, Vito Sanaj, Mhill Ftoni, Nikoll Gerla, Mhill Bregu, Ndoc Bregu, Luigj Ladhinaj, Anton Kosteri, Arber Raja, Edmond Terthorja, Roza Pjetri, File Strugaçi, Kole Çardaku e Gjon Dukgilaj. I falënderojmë dhe mirënjohje për kontributin e tyre!

*Me datën 21 maj 2018, morëm pjesë në 45 vjetorin e kryengritjes e të burgosurve në burgun e Spaçit, që u zhvillua me datën 21 maj 1973, i organizuar nga Komisioni për Drejtësi e Paqe.

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë veprimtari, zoti Luigj Mila.

*Ma datën 27 qershor 2018, morëm pjesë në dekorimin e Monsinor Angelo Massafra, me dekoratën “Nënë Tereza”, i propozuar nga kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta.

Mundësoj pjesëmarrjen, anëtar i shoqatës, zoti Luigj Mila.

*Me datën 30 qershor 2018, morëm pjesë në Ditën e Plisit të Bardhë, në fshatin Uçë të Komunës së Istogut. Në këtë veprimtari përveç përshëndetjes së rastit, u nderuan me titullin “Mehmet Shpendi” tre dëshmoret e shkollës së këtij fshati, Hasan Hysenaj, Bajram Hoxha e Muharrem Hysenaj, të cilët në vitin 1992, me jetën e tyre kane mbrojtur shkollën shq-

ipe në fshatin Uçë. U nderuan me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”, shkolla 9 vjeçare “Tre dëshmorët e shkollës shqipe” dhe poeti Gjon Gjergjaj.

Mundësoi pjesëmarrjen e grupit të Shoqatës çifti Monda e Gjon Dukgilaj, të cilët i falënderojmë!

*Me datën 15 korrik 2018, morëm pjesë në përkujtimoren e të rënëve në Qëndresën e dukagjinave, në Plan, në muajin korrik 1915, kundër ushtrisë malazeze, me rastin 103 vjetorit, i organizuar nga Bashkia Shkodër. Në këtë pjesëmarrje u përshëndet dhe u vendos kurore me lule pranë lapidarit të ngritur për të nderuar të rënë.

Mundësoj pjesëmarrjen Motër Dukate Radoja, të cilën e falënderojmë në mënyrë të veçantë!

*Me datën 4 gusht 2018 morëm pjesë në paraqitjen e katër librave, me titull “Dita e Plisit” të autorëve: aktori Ismet Krasniqi-Lala dhe poetit Prend Buzhala, në fshatin Orllan, në Komunën e Podujevës, te kulla e dëshmorit Zahir Pajaziti. Me këtë rast, u dha opinionin i ynë mbi librat dhe për dëshmorin Zahir Pajaziti u dha titulli i nderit “Mehmet Shpendi” dhe grupit organizator, Ismet Krasniqi, Prend Buzhala, Idriz Berisha, Gjon Gjergjaj, Migena Arllati e Raif Gashi ju dhurua nga një kopje të librit, me materialet e Konferencës së Arsimit, me titull “100 vjet arsim e kulture në Dukagjin”.

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë veprimtari, Motër Dukate Radoja, Anton Kosteri, Pal Lera e Gjon Kosteri. Ju fale-minderit!

*Me datën 21 tetor 2018, ditë e Dielë, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër, u mbledh Konferenca e VI e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me pjesëmarrjen e delegatëve që përfaqësonin degën e Shkodrës, Tiranës, Malësisë së Madhe, Lezhës e Kurbinit. Në Konferencë morëm pjesë një grup përfaqësues të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë – Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, me Kryetarin e saj, z. Ukshin Jashari; përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Malësia e Madhe”, zoti Ilmi Kurti, Alfred Haxhari; përfaqësues i Shoqatës “Dukagjini”, në Miçigan, zoti Ndre Guri; përfaqësuesi i Shoqatës “Mirëdita”, zoti Gjon Bruçi; Anëtar Nderi të Shoqatës, profesor Ahmet Osja e Gjergj Preluca. Pas mbajtjes së raportit pesë vjeçar dhe diskutimeve, u kalua në zgjedhje të strukturave drejtuese të Shoqatës, dhe u rizgjedh kryetari Ndue Sanaj dhe anëtarët e Këshillit të Shoqatës, kryetari i së cilës është zgjedhur, av. Agim Martin Gilaj.

Mundësoj përgatitjen e zhvillimin e punimeve të Konferencës VI të Shoqatës, z. Gjergj Leqejza, znj. Roza Pjetri, z. Ndue Sanaj, z. Agron Hasanaj, z. Luigj Shyti, z. Prelë Shytani, z. Pal Lera, z.

DITA BOTËRORE PËR TË VARFËRIT- MESHHA SHENJTE HOMELIA E ATIT TË SHENJTË FRANÇESKUT

Bazilika e Vatikanit - E diela XXXIII e Kohës gjatë Vitit, 18 nëntor 2018

Le të shohim drejt tri veprimeve që Jezusi kryen në Ungjill!

I pari. Në kulmin e ditës, lë: lë turmën në momentin e suksesit, kur brohoritej sepse kishte shumë bukë. Dhe, ndërsa dishepujt donin të gëzonin lavdinë, menjëherë i detyron të ikin dhe përcjell turmën (krhs. Mt. 14,22-23). I kërkuar prej njerëzve, shkon vetëm; kur gjithçka ishte “në zbritje”, ngjitet mbi mal për t’u lutur. Pastaj, në zemër të natës, zbret nga mali dhe arrin të tijtë duke ecur mbi ujërat

e trazuara nga era. Në gjithçka, Jezusi shkon kundër rrymës: më parë lë suksesin, pastaj qetësinë. Na mëson *guximin për të lënë*: për të lënë suksesin që fryn dhe qetësinë që vë në gjumë shpirtin.

Për të shkuar ku? Drejt Hyjit, duke u lutur, dhe drejt kujt ka nevojë, duke dashur. Janë thesaret e vërteta të jetës: Hyji dhe i afërmi. Të ngjitemi drejt Hyjit dhe të zbresim drejt vëllezërve, ja udha e treguar prej Jezusit. Ai na shkëput nga të kulloturit pa shqetësim në fushat komode të jetës, nga të jetuarit me përtaci mes kënaqësive të vogla të përditshme. Dishe-

pujt e Jezusit nuk janë bërë për qetësinë e parashikueshme të një jete normale. Si Zoti Jezus, jetojnë ecjen e tyre, të lehtë, të gatshëm për të lënë lavditë e momentit, të vëmendshëm për të mos u lidhur pas të mirave që kalojnë. I krishteri e di se atdheu i tij është diku tjetër, e di që është që tani – siç kujton Apostulli Pal në Leximin e dytë – “bashkëqytetar i shenjtërve dhe familjar i Hyjit” (krhs. Ef. 2, 19). Është një udhëtar i shkathët i ekzistencës. Ne nuk jetojmë për të grumbulluar, lavdia jonë qëndron në lënie e asaj që kalon për të mbajtur atë që mbetet. T’i kërkojmë

Hyjit që t’i ngjajmë Kishës së përshkruar në Leximin e parë: gjithnjë në lëvizje, eksperte në lënie dhe besnike në shërbim (krhs. Vap. 28, 11-14). Na zgjo, o Zot, nga qetësia dembele, nga bunaca e qetë e por-teve tona të sigurta! Na zgjidh nga lidhjet e vetëreferimit që i hedh zhavorr jetës, na liro nga kërkimi i sukseseve tona! Na mëso, o Zot, të dimë *të lëmë* për të hedhur themelet e udhës së jetës në tënden: drejt Hyjit dhe drejt të afërmit!

Veprimi i dytë: në kulmin e natës Jezusi jep zemër. Shkon tek të tijtë, të zhytur në errësirë, duke ecur

Kolë Çardaku.

*Me datën 27 tetor 2018 morëm pjesë në përvjetorin e pestë të Ditës së Plisit në Boletin. Në fillim u ndalua në qendër të Mitrovicës ku ishte vendosur monumenti i Isa Boletinit dhe u bënë homazhe, pastaj shkua në Boletin, te kulla e Isës. Me këtë rast u përsheëndet dhe për heroin Isa Boletini, ju dha titulli “Mehmet Shpendi” dhe titulli “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” për Halit Baranin, njëri nga luftëtarët e papërkulur për të drejtat e njeriut. Me këtë rast, Shoqata u nderua me titullin “Mirënjohja”

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë vepërimitari, zoti Ndoc Fusha, të cilin e falënderojmë dhe e urojmë me shprehjen popullore “Paçi e dhënçi!”

*Me 28 tetor 2018, morëm pjesë në veprimtarinë artistike, në Pukë, të pagëzuar me emrin “Festa Pukjane”, me ftesë të grupit organizator, me në krye Vladimir Prenga e Rrok Gjoka, të cilët me mbështetjen e biznesmenëve të shumtë e të nderuar të Pukës dhe të Bashkisë Pukë, me Kryetarin Gjon Gjonaj, me pjesëmarrjen e artistëve të nderuar të Pukës e më gjerë, me të cilët krijuan një atmosferë festive në shtëpinë e Kulturës “Ndue Shyti”.

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë feste, Zef Gjini, kryetari i Degës së Shoqatës “Mirëdita”, në Shkoder. Faleminderit i nderuar Zef Gjini!

*Me datën 11 nëntor 2018, ditë e dielë, në ora 14.00 deri në ora 18.00, Shoqata e Miqësisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, u organizua veprimtaria kulturore, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, me temë: “100 vjetori i Komitetit për mbrojtje e Kosovës dhe festave të Nëntorit, në shenjë respekti dhe kujtimi për të gjithë mësimdhënësit e brezave, me qëllim që ne të shkruajmë dhe të flasim shqip. Gjithashtu dhe një nderim i veçantë për mësimdhënësit e viteve 90-të, që me sakrificë të mëdha i dolën ballë për ballë okupatorit serb dhe nuk lejuan mbylljen e vatrave mësimore”. Pas përshëndetjes së rastit, nderuam me titullin “Mehmet Shpendi” SBASHKU (Sindikatesë së Bashkuar të Arsimit, Shkencës e Kulturës), Martin Dreshaj (pas vdekjes), dhe Shaban Murat Jashari (pas vdekjes). Me titullin “Mirënjohja Martin Camaj” nderuam: SBASHKU (Sindikatesë së Bashkuar të Arsimit, Shkencës e Kulturës) dhe shkrimtarin Rrahman Jashari.

Nga grupi i shoqatave: Shoqata “Mar-

tin Dreshaj”, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, Ansambli Autokton “Rugova” dhe Drejtoria e Teatrit “Aleksandër Moisiu”, nderuan me titull nderi “Pishtari i Arsimit”, Luigj Shyti, Gjyste Shyti, Kole Çardaku, Prele Shytani e Aleks Dushi, me motivacionin “Për kontributin e dhënë në arsimimin e brezave nder vite, në detyrën fisnike si mësues dhe drejtues të shkollave”.

Mundësoj realizimin e kësaj pjesëmarrjeje zoti Daniel Çardaku, të cilin e urojmë, me urimin popullor “Paçi e dhënçi!”

*Me datën 26 nëntor 2018, morëm pjesë në konferencën shkencore, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, me ftesë të Drejtorit të revistës “Illyricum – Dea”, revistë letrare, shkencore e kulturore, që botohet në disa gjuhë dhe botohet në Prishtinë-Zagreb. Profesor Rexhep Abazi.

Kjo konferencë u hap me një dokumentar kushtuar Gjergj Kastriotit, pastaj vijoj me disa trajtesa. Në fund u ndanë disa çmime. Ne u nderuam me “Çmimi i dyte”.

*Me datën 1 dhjetor 2018 morëm pjesë në Simpoziumin shkencor, të pagëzuar me emrin “Nikaj – Merturi në shekuj”. Në këtë simpozium morën pjesë 40 lektor nga të gjitha trevat e Shqipërisë Veriut nën drejtim të Dr. Mark Palnikaj. Pasi u përshëndet në emër të Shoqatës, Dr. Mark Palnikaj u nderua me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”.

*Me datën 24 nëntor 2018, në mjediset e bibliotekës së Muzeut, në Tiranë, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dega e Tiranës. Kryetar i Degës së Tiranës, u rizgjodh zoti Zef Bari.

*Me datën 25 nëntor 2018, në mjedisin e Bar-Restorant “TRADITA”, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Dega Shkodër. Kryetare e Degës së Shoqatës u zgjodh zonjusha Age Martini.

*Me datën 2 dhjetor 2018, me Sekretarin e Shoqatës, Anton Kosterin morëm pjesë në mbledhjen e degës së Lezhës, për zgjedhjet në këtë degë. Kryetar i saj u rizgjodh zoti Mirash Ftoni.

Në këto realizime është mundësia i zotit Gjergj Leqeja, me 95 000 lekë; Ndue Ftonit me 71 000 lekë; Kole Çardaku me 71 000 lekë; Anton Kosteri me 27 000 lekë, Moter Dukate Radoja me 20 000 lekë; Preke Gjonaj me 16 600 lekë;

Vito Sanaj me 16 600 lekë; Sokol Sterbyçi me 16 600 lekë; Mhill Ftoni me 16 600 lekë; Nikoll Gerla me 16 600 lekë; Gjovalin Shyti me 15 000 lekë; me Ndoc Selimi 12 600 lekë; Roza Pjetri me 10 000 lekë; Edmond Terthorja me 10 000 lekë; Arber Raja me 10 000 lekë; Mhill Bregu me 8 300 lekë; Ndoc Bragu me 8 300 lekë; Luigj Ladhina me 8 300 lekë. Gjithsej 449 500 lekë. Ju faleminderit dhe paçi e dhënçi.

Në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës do të ndalemi në disa probleme që na kane shqetësuar në këtë vit dhe dëshirojmë që të mos përsëriten në ardhmen:

Së pari, Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” ka punuar dhe punon në bazë të një statuti, në të cilin janë të përcaktuar detyrat e të drejtat e secilit anëtarë të shoqatës, të secilit anëtarë të strukturave drejtuese. Por kërkesat e statudit nuk po zbatohen plotësisht. Këtë problem e kemi ngritur dhe në raste të tjera, por duket se, ne nuk kemi ditur të kërkojmë, të organizojmë, ose disa anëtarë të shoqatës kanë ardhur në shoqatë për “luks” dhe ne kemi rënë në prehrin e tyre, në veçanti kryetaret e degëve. Në nenin 7, përcaktohet: “... Kuota vjetore do të jetë 1 000 leke në vit, por kanë paguar në këto 5 vite, vetëm 5 % e anëtarësisë. Po të paguheshin kuotat, sot do të kishim zyren e shoqatës, ose do mundësohej botimi i dy librave, pasi do arkëtohej një shumë prej 215 000 lekësh. Anëtar shoqate duhet të jetë vetëm ai që zbaton Statutin.

Së dyti, në nenin 3, përcaktohet: “Degët e Shoqatës krijohen mbi bazë rrethi, ... në hapësirat shqiptare ... dhe në diasporë, kur ka mbi 8 vete. Ato derdhen në llogarinë e shoqatës 50 % të të ardhurave të tyre që sigurohen sipas statudit, pjesa tjetër përdoret për nevojat e degës Ky nen i statudit nuk po zbatohet nga degët, me përjashtim të degës së Tiranës, e cila lëviz diçka, mundohet të zhvillojë ndonjë veprimtari.

Së treti, Shoqata është krijuar, ti bashkojë dukagjinast, për ti dhënë emrin që meriton Dukagjini. Të ndarë, të përçarë nuk mund të zësh vendin që të takon. Figurat e dekoruara të zonës sonë janë propozuar nga Kryesia e Shoqatës. Për këtë i jemi shumë mirënjohës Institucionit të Presidentit, që na ka miratuar propozimet tona. I jemi shumë mirënjohës Presidentit Alfred Moisiu, që na ka dekoruar me

dekoratën “Shqiponja e Artë”, Mehmet Shpendin, në kuadrin e 90 vjetorit të rënies së tij; Presidentit Bamir Topi, që na ka dekoruar piktorin Lind Delija dhe albano-logun Martin Camaj, me dekoratën “Nderi I Kombit”; presidentit Bujar Nishani, që na ka dekoruar atdhetarin Mehmet Shpendi, profesor Kole Prelën e zonën e Dukagjinit, me dekoratën “Nderi I Kombit” dhe poetin Frederik Rreshpja, me titullin “Mjeshtër I Madh”; presidentit Ilir Meta, që na ka dekoruar Monsinor Angelo Massfra, me dekoratën “Nënë Tereza”. Për t’u realizuar këto dekorime ishte e domosdoshme mbështetja e strukturave të pushtetit vendor, të cilat na kane mbështetur deri në nivelin më të larta të shtetit, deri te Institucioni i Presidencës. Ky bashkëpunim duhet të vijojë dhe në të ardhmen pa asnjë paragjykim. Duhet të bashkëpunojmë në mënyrë të veçantë me anëtarët e Këshillit të Bashkisë Shkodër, të Malësisë së Madhe dhe të Vaudejës, që janë dukagjinast, se vetëm në këtë mënyrë mund të mbështetemi në realizimin e misionit tonë.

Mbi bazën e realizimeve të vitit 2018 dhe detyrave që dolën nga Konferenca e VI-të e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për vitin 2019, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në tërësi të punojë me këtë Plan të Veprimtarive:

*Vijimi i botimit të gazetës “Dukagjini”, me 16 faqe, në çdo muaj.

*Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë dhe propozimi i masave konkrete në ndryshimin e gjendjes, në muajin Maj.

*Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge, veçanti në Manifestimin “Zëri i Vëllazërisë-2019”, që organizohet nga Shoqata “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, në muajin Prill.

*Marrja pjesë në manifestimin “Dita e Plisit të Bardhë” në Zym të Hasit, në Komunën e Prizrenit, që organizohet nga Grupi i Klinës me në krye Ismet Krasniqi, në muajin Qershor apo Tetor.

*Përgatitja e zhvillimi i një konference shkencore, kushtuar shkrimtares amerikane, Roza Lajne, në muajin Tetor.

*Rindërtimi i monumentit të albano-logut Martin Camaj dhe ri-inaugurimi i tij, me rastin e 94 vjetorit të lindjes së tij, në muajin Korrik.

**Ndue Sanaj,
Kryetari i Shoqatës Atdhetare
“Dukagjini”**

folklorin muzikor të Nikaj Mërturit.

17. Mhill Ndrepepaj – Gjonpepaj - Një nga të tri degët e fi sit Nikaj

18. Ndue Doshi (Kolndreu) - Lidhjet e fi sit “Mërturi” me fi sin “Berisha” dhe zhvendosja e banorëve nga Mërturi i Gurit në krahun e djathtë të lumit Drin.

19. Gjon Markokaj - Lojrat popullore dhe sporti në Nikaj Mërtur.

20. Prenda Palnikaj – Roli i femrës në bashkësitë fi snore Nikaj dhe Mërtur.

21. Pjetër Halili - Bujqësia në krahinë Nikaj Mërtur (tradita dhe ecuria)

22. Ing. Sokol Meshi - Të dhëna hidrike për krahinë Nikaj Mërtur.

23. Kol Progni - Nikaj Mërturi - pozita gjeografi ke, kufi jtë dhe madhësia.

24. Agron Prebibaj - martiri Fetë Sadiku, në panteonin e historisë.

25. Ing. Petrit Imeraj - Alpet Shqiptare, Nikaj Mërtur, Flora & Fauna

26. Dr. Gjergj Papeleka - Njoftime historike mbi zhvillimin e shërbimit shëndetësor në

krahinë e Nikaj Mërturit.

27. Ded Vukaj – Nikaj Mërturi nën administrimin Austro - Hungarez në vitet 1916 -1918.

28. Dedë Qokaj - Dukuri sociolinguistike dhe sekuenca nga Nikaj Mërturi.

29. Gjin Gjonpali – Poetët e Nikaj Mërturit, vështrim letrar.

30. Pjetër Meta – Fshatrat Peraj dhe Le-kbibaj ndër breza.

31. Dr. Mark Palnikaj – Ndryshimi në vijimësi në nivelin kulturor në Nikaj Mërtur.

32. Dr. Zef Mulaj - Bimësia Mjekësore në Luginën e Nikaj Mërturit.

33. Prof. Dr. Anton Papeleka - Skendër-beu dhe krahina e Nikaj Mërturit.

34. Prof. Dr. Lush Culaj - Hysni Curri, nënkryetar i Komitetit të Kosovës

35. Ing. Stak Vukaj, Ing. Martin Geci - Të dhëna gjeologo - minerale, dukurite fi ziko -

gjelogjike të krahinës Nikaj Mërtur.

36. Prof. Dr. Gjovalin Gruda & Nireta Gjonpjetra - Veçoritë morfologjike të pellgut Nikaj

Mërtur

37. Dr. Ylli Prebibaj – Nikaj Mërturi në vështrimin e disa hulumtuesve të huaj.

38. Prof. Dr. Zef Gjeta - Kanuni dhe Nikaj Mërturi .

39. Lek Dedndreaj – Mbarështrimi i blegtorisë në zonën e Nikaj Mërturit.

40. Ndoc Mulaj – Nikaj Mërturi dhe Turizmi.

Nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, moren pjese Ndue Sanaj, prof. As. Zef Gjeta, Zef Bari e File Moshqeti.

Ndue Sanaj, përshendeti në emër të shoqatës, që në mes të tjerave theksoj: “Kënaqësi e veçante, që në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, të përshëndes në këtë Simpozium Shkencor, me një teme mjaft të rëndësishme, të pagëzuar me emrin e madh “Nika-Mërturi në shekuj”: “Ju lumtë! Me faqe të bardhe! Ju priftë e mbara punimeve të këtij simpoziumi shkencor!”

Jo në pak raste dëgjon shprehjen: “Ka ardhur kohe e keqe!” Jo, asnjëherë nuk ka kohe të keqe, por ka sisteme, drejtues shtëpie, drejtues familje apo drejtues bashkësie jo të mirë, të cilët nuk kane ecur me kohën, nuk kane jetuar me gjendjen dhe për të qene të mençur, që të përfitojnë prej saj,



në emër të familjes, në emër të bashkësisë që drejtonte apo dhe në emër të kombit, që atë ta ngrejë në nivelet e kërkesave të kohës. Dhe nga ata që nuk kane njohur kohën, gjendjen e saj, jo në pak raste, kane çuar drejt greminës shtëpinë, familjen, bashkësinë dhe deri kombin. Mendoj, se kjo duhet kuptuar drejte, sepse, jo në pak raste e kane lenë familjen, bashkësinë dhe deri kombin në mjerim, në injorance dhe me mendësi primitive, sa dhe sot jo pak po i vuajmë. Me mendësi primitive po ecim jo pak, prandaj duhet të bëjmë përpjekje të largohemi nga folklorizmi, të largohemi nga mendësitë primitive, se jo në pak raste të dhënat që gjejmë nuk po ja çojmë arsyes, se ajo nuk të le të gabojmë. Jo pak, të huajt, dhe vendas kane shkruar për ne, por jo pak prej tyre nuk kane qene kurrë në këto vende, dhe vijojnë me atë, që ka shkruar dikush para tij, pa e ballafaquar atë në terren, dhe pse mundësitë janë sot më

shumë se kurrë. Kështu mund të themi për Gurin e Lekes në afërsi të fshatit Malagji, gjoja Leke Dukagjini kaloi vitet e fundit të jetës së tij. Apo, për “Kullën e ngujimit” në Theth, që të paret tanë kurrë nuk patën kulle ngujimi në baze fshati, se secili që pati probleme, u ngujua në kullën e tij.

Ja dhe ky simpozium i organizuar nga dr. Mark Palnikaj, thotë shumë. Ja një shëmbull i shkëlqyer i juaj, duke shfrytëzuar kohën, tregon, se është mundësia të shkruajmë atë qe duhet shkruar e të mos ja lemë kohës, gojëdhënave, e cila jo në pak raste ka shtuar e ka hequr dhe siç thotë një shprehje popullore kuksiane: “Shto mjell e shto ujë e bëhete buka e tjetër kujt!”. Pra, ky simpozium nuk ja le kësaj shprehje, por gjerat i shkruan, duke zbatuar thënie filozofike “... shkruaj, po nuk pate letër, shkruaj në gurë!”. Kjo është e rëndësishme, në veçanti për brezat që vijne, të cilët historinë, kulturën, etnografinë, ngjarjet i gjejnë

të shkruara.

Ju lumtë!

Në mbyllje, dr. Mark Palnikaj, me ftesën që i bëri Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për të marre pjese në këtë simpozium, sigurisht që e falënderojmë, por, me këtë ftesë bëri dhe dy të mira: **Së pari**, po tregon gjithnjë e më shumë, se është shumë vital, shumë i përkushtuar dhe është për tu marre shëmbull; **Së dyti**, futi në pune Kryesinë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, e cila vendosi, për punën e bërë, dr. Mark Palnikaj, ta nderoj me titullin “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion “**Për ndihmësen e çmuar që ka dhënë në hulumtimin, studimin dhe publikimin e vlerave historike të zonës së Pultit mesjetar dhe popullit shqiptar në tërësi**”.

Përgatiti Zef Bari e File Moshqeti

ANALIZË ME NDJENJËN E PËRGRJEGJËSISË

Në zbatim të detyrave që shtroi Konferenca e VI-të e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", edhe në Degën e Lezhës, u zhvillua analiza e realizimit të objektivave të kësaj dege që nga Konferenca e V-të. Kjo analizë përkoi edhe me zgjedhjet e organeve drejtuese të kësaj dege. Analize u zhvillua me datën 02.12.2018, në një resort të mbrekullshëm në pronësi të biznesmenit të njohur Lezhian z. Dedë Gjeloshi.

Në këtë analizë mori pjesë Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", "Nderi i kombit" z. Ndue Sanaj dhe Sekretari i Shoqatës, z. Anton Kosteri. Raportin e mbajti Kryetari i Degës z. Mirash Ftoni. Në raport doli puna e mirë e bërë nga anëtarët e Shoqatës dhe të metat e dobësitë e konstatuara gjatë periudhës raportuese. Kjo analizë u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë. Pjesëmarrja ishte e kënaqshme. Nuk munguan pyetjet dhe diskutimet nga të pranishmit. Të gjitha pyetjet dhe diskutimet theksin e kishin të përmirësimit i punës në Degë. Në mes të



tjerëve diskutoi z. Fran Marku, ku u ndal te promovimi i vlerave të Dukagjinave të cilat janë ndër më të mirat e kombit tonë. Në vazhdim të fjalës tij, ai doli me dy propozime konkrete: T'i propozohet në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Bashkisë Lezhë për shpalljen "qytetar nderi" Nikoll Vocaj pas vdekjes dhe Dedë

Marashit." Per kontributet e dhëna në qytetin e Lezhës" Propozim i cili u miratua njëzëri nga të pranishmit.

Pastaj e mori fjalën Nikoll Gjeloshi, i cili u përqendrua tek aktivizimi në Degën e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" për rrethin e Lezhës, sa më shumë të rinjtë Dukagjinave, të cilët sot kanë bërë emër të

mirë në disa sektorë si në administratën e Bashkisë ashtu edhe shumë prej tyre janë biznesmenë të njohur. Rëndësi ka se Dukagjinave kanë bërë emër në rrethin e Lezhës dhe ky komunitet gëzon respektin e të gjitha komuniteteve të tjera që banojnë në këtë rreth. Prandaj ne duhet të promovojmë sa më mirë vlerat e Dukagjinit e Dukagjinave. Pastaj u kalua në zgjedhjet e reja ku: Kryetar i Degës u rizgjodh, Z. Mirash Ftoni dhe Sekretar Z. Nikoll Gjergj Kola. Për të ndjekur problemet financiare u zgjedh Z. Fran Marku.

Në fund e mori fjalën z. Ndue Sanaj. Theksi në fjalën e tij e vuri në detyrat që dalin për të ardhmen. Të behet një program për zbatimin e detyrave që ka shtruar Konferenca e VI-të e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Uroj të pranishmit për suksese të reja. Gjithashtu ai uroi të gjithë Dukagjinave kudo që janë brenda vendit dhe në botë ". Gezuar festat e fundvitit, mbarësi e lumturi në jetë e familje. Për të pranishmit u shtrua një koktej i larmishëm.

Përgatitur nga **Ndue Zici**

SA MË PAK FACEBOOK, WHAT'S UP DHE VIBER NË KËTO FESTA FUNDVITI

Jemi në muajin Dhjetor dhe në prag të festave të Fundvitit të cilat i presim me padurim secili prej nesh. Duke patur këtë të mendje, nisur nga titulli i këtij artikulli, tingëllon si fillim jo aq pozitive " Sa më pak facebook, what's up dhe viber në këto festa fundviti". Përse?

Së pari sepse ne mund të qëndrojmë në facebook, viber dhe what's up pranë njerëzve që i duam, me të cilët duam vërtet të komunikojmë edhe pse jemi në anën tjetër të botës. Megjithatë, nga ana tjetër, ne shohim gjithnjë më shumë njëri-tjetrin dhe të tjerë njerëz të ngatërruar në botën virtuale dhe të izoluar nga ata që janë nga ata pjesë faktike dhe konkrete e jetës. Kjo rezulton alarmuese dhe tregon që është e nevojshme të diskutohet ndikimi i ekzagjeruar i teknologjisë në marrëdhëniet ndërpersonale fizike në "botën reale" apo "jetën e përditshme".

Është e bukur të takojmë njerëz me kombësi dhe kultura të ndryshme dhe është interesante të qëndrojmë në kontakt me miqtë tanë dhe familjet që jetojnë larg në internet, por nuk është e shëndetshme për ne të zëvendësojmë ose të neglizhojmë prezencën fizike, emra, biseda të sinqerta, kohën e argëtimit që mund të kalojmë me njeri-tjetrin. Ne jemi qenie sociale, jetojmë në një shoqëri që ecën në raport me njëri-tjetrin, dhe kështu mesazhet e teksteve dhe emoji nuk do të jenë kurrë më të vërteta për të na treguar se ekzistojmë në botë.

Rrjetet sociale, edhe pse na afrojnë me ata njerëz që i kemi larg, na largojnë edhe nga ata që janë afër, kjo është një fakt i cili po perceptohet edhe në analizën më të shpejtë të shoqërisë. Personat flasin gjithnjë e më pak, nuk shikohen më në sy dhe

nuk dinë më si të krijojnë marrëdhënie të gjalla sepse janë shumë të zënë me një shikuar në ekranet e tyre të telefonave celular dhe me një "pëlqej" në të shumtën e rasteve apo me një urim "mekanik".

Ja pra, ne kemi nevojë dhe domosdoshmëri të thjeshtësojmë përsëri jetën tonë, duke krijuar një ekuilibër midis jetës reale dhe jetës në internet.

Ne kemi nevojë për më shumë emra dhe më pak Whatsapp, Viber apo Facebook, për më shumë momente ballë për ballë dhe më pak mesazhe, më intensitet, momente të jetës që lidhen me shpirtin tonë, një lidhje më të ndjeshme me veten tonë dhe njerëzit që na rrethojnë.

Duhet të mësojmë dhe të pranuar veten më shumë dhe të varemi sa më pak që është e mundur nga ato "fiktive" për të pranuar të vërtetën tonë.

Avantazhet e teknologjisë janë të pamohueshme dhe ndikimi i tyre në botën tonë është pozitiv, por ne duhet të mësojmë se si ta përdorim atë me kufi në mënyrë që të jetë një plotësim pozitiv në jetën tonë, por në atë mënyrë që të bëhet jeta jonë ir-reale, pra ajo "që do të donim të kishim"

Pra shtoni më shumë realitet në jetën tuaj! Dilni nga telefoni juaj celular dhe festoni në këto festa fundviti me njerëzit që janë rreth e rrotull jush, që janë momentalisht me ju. Takohuni, përpikuni të flis-

ni, udhëtoni, shikoni sa më shumë të jetë e mundur me njerëzit në jetën tuaj. Mbani parasysh se një pajisje elektronike kurrë nuk do të jetë më mirë se një shoqëri e vërtetë, nuk duhet të mësohemi të jetojmë prapa ekranit, jo, kurrsesi, kur kemi një botë të mrekullueshme për të jetuar dhe njerëz me të cilët të mund të bashkëndajmë si gëzimet po ashtu edhe hidhërimet tona. Kjo është një nga pasuritë më të çmuara të jetës! Gezuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2019!

Përgatitur nga **Suela Ndoja**



NJË HISTORI, QË NUK HARROHET, JO VETËM NË FSHATIN E LARGËT TOPLANË

Dy djem dukagjinas, në vitin 1977, në ditët e para të marsit, shprehën gatishmërinë për të shpëtuar dy jetë njerëzish, nëna shtatzënë bashkë me krijesën e saj rrezikohej për të humbur jetën. Për ata që nuk e dinë, Toplana është një fshat, zonë e thellë malore, e izoluar, me mundësi të pakëta për të realizuar nga personeli mjekësor i zonës një ndërhyrje të specializuar, që do të siguronte që Age Pelhuri do të kishte vijimësinë e jetës së saj dhe të fëmijës së pafajshëm, por që e kishte çuar në zgrip jetën e nënës së vet. Për situatën e krijuar u dha alarmi. Lufta për të shpëtuar dy jetë njerëzish në Dukagjin ndezi motorrat e helikopterit, që me mjekë të specializuar për këto situata do të udhëtonin drejt Veriut nga Tirana, në kohë rekord. Njofimi i nisjes së mjetit ajror u prit me gëzim nga familjarët dhe banorët e fshatit, të cilët kishin dalë ta presin në vendin e mundshëm të zbritjes. Gëzimi u shtua edhe më shumë kur u muar vesh se helikopteri drejtohej nga piloti i shquar, biri i Brashtës e i Dukagjinit ndue Logu si dhe mjeku që do të mbikqyrte rezistencën e Ages për aq kohë sa donte mbërritja në Tiranë, edhe ky një dukagjinasi tjetër mjek i talentuar, gjinekologu Zef Delia. Pavarësisht se situata ishte e vështirë për nënën, familjarët kishin përgatitur drekën për ekipin e shpëtimit për ti nderuar ata. Por piloti dhe mjeku me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë, pasi i falenderuan për pritjen, me shpejtësinë maksimale u nisën dhe mbërritën në Tiranë ku Zefi bëri ndërhyrjen e nevojshme, duke shpëtuar jetën e Ages dhe të vajzës së saj. Të dyja sot nënë e bijë jetojnë të gëzuara në familjet e tyre, me një mirënjohje të thellë për ata që u shpëtuan jetën mbi 40 vjet më parë.

Dreka e përgatitur për ekipin e shpëtimit nga familjarët dhe drejtuesit e fshatit mbeti e paprekur deri sa u dha lajmi i gëzuar, se operacioni doli me sukses, jeta është e garantuar për nënën e vajzën e saj. Atëherë shpërtheu gëzimi, i shoqëruar me dolli në trevesen bujare të malësorit për pilotin dhe mjekun dukagjinasi, që me shpejtësinë dhe ndërhyrjen e tyre, bënë që jeta të mos këputet për ato dy krijesa njerëzore.

Tani le ti kthehemi ekipit të shpëtimit.



Piloti Ndue Logu

Po e emërtojmë kështu, sepse ata së bashku, kanë rënë kryq e tërthuar hapësirës ajrore të Shqipërisë, ditën e natën, në zona të thella malore, atje ku kërkonte jeta e rrezikuar. Por udhëtimin për në Dukagjin ata e përjetuan me emocione të forta e Dr. Zefi edhe sot i kujton ato moment prekëse që përjetuan për çaste midis banorëve të Toplanës.

-Ndue Logu, ky i shquar i Brashtës dhe Dukagjinit, është bërë i njohur prej kohësh, si një njeri me të tëra cilësitë më të larta njerëzore, si një ushtarak i zoti, si një pilot shqiponjë i lartësive të kaltra shqiptare, si një hero që sakrifkoi jetën e tij për të shpëtuar jetën e ushtarëve, të cilët po përgatiteshin në poligonin luftarak. Një njeri krenar për vendlindjen, sa herë kalonte mbi ato hapësira jepte mesazhe përhëndetëse për të gjithë njerëzit e tij të dashur, për nënën e tij të moshuar, për atë truall që lindi burra të shquar, patriot e luftëtar të vendosur si Marash Tuci, Gjini Marashi, Kolë Gjoni.

Ja se si e përshkruan dhimbjen e thellë nipi i tij, poeti i talentuar Shkëlzen Logu, për axhën Ndue Logu, ky pilot me shpirt të madh, për të cilin është krenar jo vetëm ai.

"Nder pilotët ish më i miri / burrë i urtë dhe zemër floriri"

"Sa jetë njerëzish ai shpëtoi / sa shumë furtunave u përballoi / e vuri kokën në rrezik / zemra e tij kurrë s'njohu frikë"

Ish pilot dhe ish lektor / permbi të gjitha ish malësor / ai djalë prej Dukagjini / syshqiponjë e zemër trimi

Kur në Malësi dritën u çove / helikopterit atje e ndalove / pa masë e çudite mbarë Malësinë / dhe të mbuluan me lavdinë

Në një zonë të thellë një grue ishte / të pamundur lindjen e kishte / U nise shpejt me helikopter / që të merrje gruan e mjerë

Sa e sa aksione ka kryer Ndue Logu nga Jugu në Veri. Shpejtësia, manovrueshmëria, sakrifica e tij, kanë shpëtuar nënën në dhjetra raste.

Por pjesëtar i grupit të shpëtimit, ishte një bir tjetër dukagjinasi, si mjek gjinekolog, të cilin piloti ynë e çonte me shpejtësi atje ku rrezikohej jeta e njeriut, e ky po me atë shpejtësi, shkathtësi e profesionalizëm vepronte, Dr. Zef Delia.

Akti heroik i Ndue Logut, sakrifica sublime për të shpëtuar njerëzit, ashtu siç shpëtoi dhjetra e dhjetra nëna në të gjithë Shqipërinë dhe krijesat e tyre, me trupin e tij duke u hedhur mbi atë granatë të mallkuar, për të mos tharë zemrat e nënave, djemtë e të cilave po hidheshin në erë nga shpërthimi i saj. Ai ishte dhe mbeti një misionar i përkushtuar në shërbim të nënave.

Harmonia e veprimeve me shpejtësinë e mjetit fluturues Ndue Logu, ato nëna që i çonte në Tiranë përfundonin në duart e mjekut gjinekolog, i talentuari Zef Delia. Këta të dy ishin krahët fluturues të shqiponjës ajrore në shërbim të njerëzve.

Dr. Zefi e vazhdoi për shumë vite misionin e tij fisnik. Ndërhyrjet e tij, ndërgjegjia e lartë e profesionalizmi e vunë në prova të vështira për vite të tëra, duke u bërë një mjeshtrë i spikatur, ç'ka e bëri me emër të madh në mendjet e zemrat e njerëzve kudo në qytet e në fshat, në veçanti në zonat e thella malore. Por Zefi, ndonëse me mision të vështirë, i vuri si objektiv punës së tij dhjetra vjeçare që ta përpujë e ta përgjithsojë eksperiencën e tij të pasur, tani si studiues i vlerësuar me gradën e lartë shkencore "Profesor". përvojën e tij e shkriu me atë ndërkombëtare në fushën e gjinekologjisë në kurse, sipo-



Mjeku Zef Delia

zume shkencore në SHBA, Itali, Francë, Austri, Hungari e të tjera.

-Tom Zefi ndonëse në moshë rreth 70 vjetësh, e vazhdon punën plot passion e energji, për të përgatitur mjek të rinj, në Universitetin e Mjeksisë në Tiranë, duke qenë model i njeriut të përkushtuar, i mjekut duar artë, studiuesit e punonjësit shkencor me një bagazh të madh teorik e praktik të vlerësuar në shkallën më të lartë.

Ky është Dr. Zef Delia, i lindur në Shkodër, i shkolluar në vendlindje e në Tiranë, bir i dy prindërve të nderuar dukagjinasi nga fshati Lekaj, për të cilët është krenar, por krenar nuk është vetëm ai, krenar jemi dhe ne dukagjinasi e fshatit e të qytetit për birin tonë të talentuar, që e ka ngritur lart personalitetin e tij, respektin dhe dashurinë e njerëzve, duke u bërë simbol e model për brezin e ri të mjekëve për ti shërbyer me devotshmëri atdheut të vet.

Martin Çetina

MEDVEGJA NË LEZHË

Me datën 5 dhjetor 2018, Drejtori i revistës "Illyricum-Dea" (revistë letrare, historike e kulturore), që drejtohet nga profesor Rexhep Abazi dhe botohet në Zagreb e Prishtinë në disa gjuhë, në bashkëpunim me drejtorin e Kulturës së Bashkisë Lezhë, Paulin Zefi, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, në mjediset e qendrës kulturore të fëmijëve "Gjergj Lacaj", u mbajt simpoziumi shkencor, me temë, "Gjergj Kastrioti, Kryeheroi me përmasa evropiane dhe botërore",

Merrnin pjesë shumë studiues, nga

Shqipëria e Kosova e deri në Kosovën Lindore, si Preng Cub Lleshi, dr. Rovena Vata, Pavlin Zefi e të tjerë.

Simpoziumi filloi me një dokumentar kushtuar Gjergj Kastriotit dhe pastaj u kalua në ligjërimin e temave.

Simpoziumi i shoqërua me këngë e valle nga grupi folklorik i Lezhës.

Në fund të simpoziumit u ndanë tituj nderi nga Drejtori i Revistës "Illyricum-Dea", profesor Rexhep Abazi.

Një titull nderi ju dha dhe z. Ndue Sanaj (Çmini i dytë).

Redaksia



EMBLEMA E GJALLË E MALËSISË SË MADHE, PROF. DR. AHMET OSJA "QYTETAR NDERI I MALËSISË SË MADHE"

Dje, në Malësinë e Madhe, në praninë e një pjesëmarrjeje të kompletuar, këshillit bashkiak, kryebashkiakut Marinaj, përfaqësuesve të shoqërisë civile, të M. Madhe, sikurse nga edhe Shkodra, Durrësi, respektivisht zotërinjtë: Ilmi Kurti, Flamur Muça, Ndue Sanaj, Alfred Haxhari, Vuksan Vukaj, Nikolla Spathari, personaliteteve akademike, të ftuar nga Tirana, prof.dr. Sokrat Jovani dhe Zef Gjeta, Bashkia M. Madhe përcolli një ditë të veçantë, mbresash nderimi dhe dinjiteti maksimal vlerash, të koncentruara në nderimin e birit të kësaj treve, prof. dr. Ahmet Osjes me titullin e lartë "Qytetar Nderi". Do të ishte pikërisht 13 dhjetori 2018 që në memorien e tij do të shënonte njërin nga momentet më të bukura, si sodisfaksion i mbarë Malësisë së Madhe nderimi me këtë titull, jo thjesht si një risi, sepse nuk qe e tillë nga pikëpamja e formës, por si një cilësi e përzgjedhjes së merituar, të kësaj embleme të gjallë të trevës sonë, malësorit Ahmet Osja, i mirënjohur dhe i nderuar mes nesh dhe në mbarë Shqipërinë Natyrore, për ato që ai ka arritur në studimet shkencore, në degën e agronomisë.

Jo rastësisht, me shumë dinjitet moral dhe profesional, do të shprehej kohë më parë prof. dr. Shukri Sh. Fetahu: "Prof. dr. Ahmet Osja është ndër ata shkencëtarë që i takojnë krenarisë sonë kombëtare, në shkencë, në dije dhe në profesion, para së gjithash një vlerë e lartë njerëzore ndër shqiptarët kudo që janë" (Prishtinë, më 1 dhjetor 2010). Ishte pikërisht ky intensitet njohjeje, sa individuale, sa përmes kontributeve reale të tij, referuar një pasurie kulturore dhe shkencore, me mbi 6 000 tituj libri elitare të bibliotekës së tij, sikur të mbi 394 artikujve shkencorë, në shtypin periodik, si revista "Shkenca dhe Jeta", "Tribuna e ekspertit", "Fokus" apo si kryeredaktor në gazetën "Kurora e Gjellbër", që më sensibilizuan të jem edhe inisiativa e propozimit, nga statusi i kryetarit të shoqatës së shkrimtarëve dhe artistëve, M. Madhe, së bashku gazetarin e talentuar Rifat Ymeri, kryetar i unionit të gazetarëve malësorë, si bashkëpropozues pranë këshillit bashkiak të M. Madhe, për dhënien e titullit "Qytetar Nderi i Malësisë së Madhe", prof. dr. Ahmet Osos, Mjeshtër i Madh, në 79 vjetorin e lindjes së tij.

Duke u ndalur në jetën dhe veprën e prof. Ahmetit ndihesh në rolin e një operatori të vonuar, që kërkon të realizojë dokumentarin e një studiuesi e shkencëtar, intelektual dhe humanisti, dituraku dhe eruditi të pashoq, ndaj të cilit shoqëria civile dhe institucionet tona, disi të mbyllura në vetminë e tyre, sa edhe nën pushtetin e një egoizmi sa partiak, sa kultpragmatist, aspak normal, brenda vetvetes, mbetën borxhli të përgjeshëm ndaj këtij ciceroni të bujqësisë shqiptare, siç do të shprehej kryetari i Akademisë së Shkencave prof.dr.Gudar Beqiraj, ndërkohë që, i dorëzonte prof. Osjes, vite të shkuara, titullin "Nderi i Akademisë së Shkencave" me motivacionin "Për kon-

tributin e shquar në zhvillimin e bujqësisë shqiptare, në aplikimin e metodave moderne të krijimit dhe prodhimit të hibrideve të misrit si dhe në edukimin e brezave të rinj". Aktualisht prof. dr. Ahmeti është anëtar nderi edhe i Akademisë së Shkencave në: Florida (SHBA), Itali dhe



Kosovë.

Ahmet M. Osja, me origjinë nga Shkrelti i M. Madhe, lindi në Luarsë të Velipojës, më 25 qershor 1939. Si merr arsimin fillestar në vendlindje, përfundon shkollën e mesme bujqësore në Tiranë si



dhe studimet e larta në Universitetin e Kamzës, në degën agronomi, me rezultate të shkëlqyera. Kudo punoi nga Dukagjini i largët, aspak thjesht si rrogar-veçori dhe tipar dallues i agronomëve të rëndomtë, (që mjeranë të mediave tona provinciale shpeshherë ia ofrojnë publikut si "intelektualë") deri tek Zooteknika në Shkodër, ku do të hapte krahët e ardhmja e një shkencëtar serioz, po aq nga Instituti i Misrit dhe Orizit në Shkodër si nëndrejtor (1982-1992) deri në pozicionin e Ministrit të Bujqësisë dhe Pyjeve (shkurt-maj 1991), sikurse edhe nga pozicioni i depu-

tetit të Kuvendit Popullor (1982-1991), apo ajo e kryetarit të Komisionit të Bujqësisë në atë parlament (1986-1991), prof. Osja do të do të shquhej për përkushtim dhe profesionalizëm në zhvillimin e përgjegjësive që i qenë besuar, si dhe në raport me bashkëpunëtorët e tij. Jo ra-

tësisht nderimi që i bëri M. Madhe do të vinte në vargun e nderimeve për kontributin e tij nga Shkodra, Mirdita, Kosova e të tjera.

Jeta e tij është jeta e një hulumtuesi serioz, po aq sa e një intelektual dhe qytetari shembullor, në të gjitha format e shprehjes së saj. Kushtrimi i thirrjes akademike, si kodi i specialistit apo shkencëtarit të vërtetë, do ta motivonte gjithnjë suksesshëm si kumtues të teknologjisë në kultivimin e misrit për kokërr dhe për silazh, në podiume të tilla shkencore si: Konferenca e gjenetikës së aplikuar (1984), ajo e blegtorisë (1987) si dhe konferenca shkencore e gjenetikës (2001) në Tiranë. Njëherësh prof. Osjen, në operacionet e tij karizmatike shkencore, do ta kemi në konferencat ndërkombëtare: Sofje (1988), Ankona (1992), Baleta-Mata (1996) dhe në konferencën e Pragës (1998). Aspak rastësisht, profesori do të jetë njëri nga botuesit në revistat shkencore ndërkombëtare si: "Tradita e ujitjes në Shqipëri", "Irrigacione", revistë italiane

(1997), botime në Buletin e shkencave bujqësore, zooteknike. Rezultatet e tij si anëtar i Këshillit shkencor, në Institutin e Tokave, Stacionin e Mekanizmit dhe Entin e Farërave, do ta "orientonin" prof. Ahmetin, në karrierën e tij shkencore, drejt stimujve: "Urdhri i Flamurit" dhe Urdhri "Naim Frashëri i Artë", dhënë nga Presidenti i Republikës, sikurse "2 000 Outstanding scholars of the 20 Contry IBC, Cambridge, CB2 3 QP", në England. Prof. Osja është autor dhe bashkautor i 13 librave për profilin e bujqësisë dhe ushqimit, sikurse pjesëmarrës në

konferenca ndërkombëtare në: Itali, Hungari, Bullgari, Kosovë, Greqi, SHBA, Mal të Zi. Mban korrespondencë të rregullt me institucione e shkencore prestigjioze, si dhe letërkëmbime me personalitete të fushës kërkimore –shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mik i pashoq i shkrimtarëve dhe artistëve, pjesëmarrës gjithë jetën në promovimin e vlerave kulturore dhe artistike në qarkun e Shkodrës. "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini". Ndër gjërat pikante të jetës së një studiuesi-personalitet, elegant-emblematik, si prof.dr.Ahmet Osja ia vlen të kujtojmë fjalën e tij si i ftuar në OKB, si specialist i bujqësisë, njëherësh edhe për takimin prej 20 minutash me Presidentin e SHBA-s, mikun e madh të shqiptarëve, Xhorxh Bush, më 17 qershor 2001, ku do të ishte i ftuar si personalitet përfaqësues i vlerave shkencore në bujqësi. Në studion e tij do të impresionohesh nga 1000 fotot, si fiksimi i takimeve dhe veprimtarive me personalitete të fushave të ndryshme nga mbarë globi. Fantastike është kultura historike, që ai të ofron me shkrimet e tij lidhur me vizitat e Heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriot –Skënderbeun në vitet "50 të shekullit XV në M. Madhe, asokohe pjesë e sundimit venedikas. Personalisht i ndjem në jetë të jetëve obligues për vlerësimin dhe inkurajimin që i ka bërë përpjekjeve të mia si studiues i letrave shqipe, kritik letrar profesionist, duke qenë njëri nga rekomanduesit kryesorë për dhënien e titullit "Qytetar Nderi i Bashkisë M. Madhe", sikurse edhe për Urdhrin "Naim Frashëri" pranë presidentit të Republikës, pozicionime të një akademiku që kurdoherë i kam parë dhe vlerësuar si vlerësime për trevën M. Madhe, nga pozicioni i malësorit human, shkencëtarit të përmasave evropiane, shembull elitare në kërkimin shkencor, përballë një page mujore, modeste, 33 000 lekë, në kontekstin e një braktisjeje të dhimbshme, nga vendi ynë, që ka mbërthyer brezin e ri, sidomos elitën e kombit.

Pas fjalës së mirënjohjes që profesor Ahmeti shprehu ndaj nderimit që Malësia e Madhe, si dhe të pranishmit i bënë me këtë rast, përmes konsideratave për veprën e tij, shumë domethënëse, mrekullisht e denjë, kushtrimoi thirrja e tij, si aleati më serioz i protestës së mrekullueshme studentore, që po vijon prej ditësh në vendin tonë, po aq si thirrja e një personaliteti madhor prej patrioti dhe intelektual, po ashtu edhe si një kushtrim akademik, po aq edhe i shpirtit të malësorit- embleme të trevës së Malësisë së Madhe: "Pashë hatrin e zotit mos pushoni, shkruani, hartoni projekte, gjeni rrugë e mundësi që të zhvillojmë këto pasuri të mrekullueshme, pyjore, ujore dhe diellore që kemi, të zhvillojmë fshatin shqiptar, mos u tërhiqni! Natyra dhe vendi ynë i ka të gjitha mundësitë për të lumturuar jetën tonë, jetën e të gjithë shqiptarëve në Shqipëri!"

Kadri Ujkaj,
Kryetar i shoqatës "Shkrimtarëve dhe Artistëve, Malësi e Madhe"

“MARJANA, HISTORIA SHQIPTARE E NJË AUSTRIAKE”

“Marjana, historia shqiptare e një austriake” është vepra e autores Lindita Sina, e cila tërhoqi vëmendjen e mjaft lexuesve, të cilët ndoqën nga afër promovimin e organizuar në bibliotekën “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës. Vepra kërkon t’iu japë përgjigje këtyre pyetjeve që do i bënte çdokush nga ne: Si arrin një grua e vetme të lë gjurmë të dukshme të një të ardhmeje europiane në një vend si Shqipëria, që ishte kthyer në një vrimë të zezë jashtë kohës? Çfarë e shtynte atë të shkelte vullnetarisht tokën e minuar të Kosovës fill pas tmerreve të luftës, për t’u dhënë njerëzve shpresë për jetën? Ku gjen ajo energji dhe kohë për të vepruar në Shqipëri e Kosovë krahas detyrimeve të jetës së saj familjare dhe angazhimit të saj të përkushtuar profesional në Austri si mësuese?

Për shumë austriakë emri i Shqipërisë lidhet me emrin, Marianne Graf. Për shqiptarët Marjana është shqiptarja austriake; për austriakët Marianne është austriakja shqiptare. Për shqiptarët Austria ka fytyrën e dashur të Marianne-s; austriakët mësojnë të shohin shqiptarët me sytë plot mirësi të saj.

Edhe pse në media është transmetuar përmes kronikave të ndryshme veprimtaria e humanistet Marianne Graf, duke e bërë atë të njohur në gjithë Shqipërinë, ne zgjodhëm një mënyrë krejt të përmblendhur të paraqesim një CV-i të shkurtër të jetës së saj, duke kërkuar ndjesë për mjaft të dhëna të lëna jashtë kësaj renditje.

Marianne Graf

Presidente e shoqatës “Partneriteti Shqipëri-Austri”, lindur më 28. 12. 1951, në Graz të Austrisë. Martuar me Dipl. Ing. Eilhelm Graf, drejtues i sektorit të menaxhimit të cilësisë dhe i laboratorit qendror të firmës “highTEX Sattler-Europe”. Arsimimi i lartë: Akademia Pedagogjike, në Graz ku dhe ka kryer Master Universitar për politikën e botës së tretë Diplomimi mbi politikën e zhvillimit. Themeloi shoqatën bamirëse “Partneriteti Shqipëri-Austri” në vitin 1992 me bashkëshortin e saj, Ing. Eilhelm Graf. Të dy mbulojnë qysh prej fillimit me të ardhurat personale të gjitha shpenzimet e shoqatës, kështu që çdo kontribut financiar shkon drejtpërdrejt për zhvillimin e projekteve. Fokusi i punës: arsimit dhe kujdesi shëndetësor, të drejtat e fëmijëve, ngritja e urave në fshatrat malore, hapja e puseve, projekte për grate, projektet e paqes, mbrojtja e pakicave, nxitja e dialogut kulturor dhe ndërftar, ekologjia, forcimi i fermerëve të vegjël.

Moto udhëheqëse e saj: “Të japim shpresë dhe ndihmë për të nxitur përgjegjësinë dhe ndihmën veti!”

Por cila është puna e Marianne Graf prej 25 vitesh në vendin tonë?

Do e nisim:

Projektet në Shqipëri:

Mbi 130 Projektet ndërtim: shkolla, kopshte, qendra mjekësore, strehimit social, shtëpitë e familjes dhe apartamente, qendrat arsimore dhe sociale të rinjve,

ura pezullimit, puse, rikonstrukcion e një dige, sallë koncertesh, salla sportive, salla kulturore, Qendra informative “INFO-KULLA”, bujtina eko-turistike etj.

Ndihma humanitare - paketa e ndihmës



hmës

Shoqata ka shpërndarë në 54 qytete dhe fshatra të Mirditës rrethet, Pukë, Shkodër, Tropojës, Kukësit, Has, Mat, Durrësit, Kurbinit për më shumë se 30 000 familje pako të mëdha të ndihmës.

Ndihma për Refugjatë për kosovarët në Shqipëri:

Fundi i majit 1998 - mars 1999



furnizimi mujor i 3 000 personave dhe deri në qershor të këtij viti shifra arriti në 13 000 personave. Shpërndarja e 42 rimorkio e 840 ton me ushqime, 4 000 batanije, 2500 dyshekë, 1 800 paketa familjare Ndërtimi i 3 fshatra të forta të refugjatëve: Mamurras: 300 kosovarë, Pukë I: 980 kosovarë, Pukë II: 250 kosovarë

Çmime e vlerësime si menaxhuese sociale mbi bazë vullnetare

11 Herë titulli “Qytetar Nderi” në Shqipëri

1996, Dekoruar nga presidenti i Republikës së Shqipërisë me urdhërin e lartë: “Nënë Tereza”

2001, Çmimi, Grand Aëard for Peace and Humanity’. (Çmimi Grand Auord for Peace end Hjumeniti)

Fituese e çmimit, Grand Johann – Aëard ‘**Öman of the Year 2002**

2003, Fituese e çmimit për humanizëm “Aëard for Humanity” – dhënë nga Michael Gorbachov dhe Helmut Kohl

2004, Doctor honoris causa e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër

2006, “Ordine San Silvestro” nderimi më i lartë i Vatikanit për joklerikët

2007, Kandidate për çmimin Nobel të Paqes, në Oslo

2016, Titulli “Kalorës i urdhrut të Skënderbeut” - rendi më i lartë i shtetit shqiptar

Përsëritja e parë në promovim u bë nga kryetarja e Bashkisë Shkodër znj. Voltana Ademi. Mes të tjerave ajo e vlerësoi znj. Graf si shembull i njerëzve që e kanë dashur Shqipërinë. “Libri besoj do hedhë dritë në kontributin e znj. Graf, një libër që shkruan të vërtetat por dhe mëson brezat e ardhshëm për veprën e njerëzve të mirë, dhe atyre austriakë”.

“Të ishim vetë si ju, atëherë Shqipëria do të ishte edhe më e mirë. Ne njohim Shqipërinë e asaj kohe dhe përpiqemi të kuptojmë të sotmen. Janë të vërteta që ne i njohim për herë të parë”,- tha në fjalën e saj poetja Arjola Zadrima.

Sjellim për lexuesit një fragment të vogël nga vepra: “Marianne kishte gjithmonë një përjetim të veçantë, kur e ftonin si mikeshë në shtëpitë e malësorëve, a thua se po shkelte në një kohë tjetër. Fjalët, lëvizjet, madje edhe vetë frymëmarrja ngadalësoheshin, a thua se të

edhe nderin e një burri. “Burrnesha” ishte trime, e urtë dhe bujare. Marianne i kishte dëshmuar këto veti në gjithë ato kohë, që kur ishte shfaqur në Rubik dhe në shumë vise të tjera të afërta e të largëta, ku vepronte prej vitesh”.

Zef Coba, kompozitori i nderuar shkodran, prej vitesh ka një bashkëpunim të ngushtë me shoqatën “Partneriteti Shqipëri-Austri”. Në fjalën e tij ai tha: “Ne takimet që kam pasur me të, e pashë se fjalët i kishte vepra. ... Ne kemi nevojë të bëjmë shumë, por hezitojmë. Ne kemi energji të jashtëzakonshme”

Donika Selimi, presidente e shoqatës “Dimension Human”, solli një përsëritje nga inxhinierja dhe shkrimtarja e një sërë enciklopedive znj. Zenepe Dibra edhe në emer të shoq. “Gruaja intelektuale shkodrane”, duke e cilësuar Marianne Graf një shpirt hyjnor

Të pranishëm në promovim ishin dhe një pjesë e grupit pedagogjik dhe nxënës të shkollës “Peter Maringer”. Një përsëritje do të vinte në emër të drejtorisë së shkollës austriake nga prof. Markus Offner: “Ju falenderojmë për angazhimin tuaj në jetën sociale, me në qendër njeriun. Nuk jemi thjesht të mahnitur për punën tuaj, por edhe gëzohemi për cimet ndërkombëtare, që ju keni marrë. Me ngrohtësi zemre dhe force prej ariu (duke citur një shprehje nga libri), të vazhdoni në punën tuaj”.

Ai që i ka qëndruar dhe mbështetur vazhdimisht në rrugën e saj të vështirë znj. Graf, ka qenë bashkëshorti i saj Eilili: “Gruaja ime është një njeri që thotë se gjithçka është e mundur dhe nuk duhet të dorëzohemi kurrë për ta arritur”.

Autoria e veprës Lindita Sina, në fjalën e saj u shpreh: “Mund të vlerësohet si një parathënie e historisë së znj. Graf. Mendoj që për mua ka qenë një kthesë psikologjike, sepse Marjana beson për një të ardhme të mirë për shqiptarët. Ajo tregon dhe rrugët që duhen ndjekur”.

Dhe ashtu sic e këkron tradita në promovime, të pranishmit ndoqën me vëmendje fjalën e austriakes së nderuar Marianne Graf, e cila i befasoi të gjithë për gënishten në shqiptimin e gjuhës shqipe. “Dua të falënderoj të gjithë sëbashku që jeni të pranishëm sonte këtu. Falenderoj z. Skënder Thacin, koordinatoren, për mbështetjen e vyer prej 26 vitesh që punoj në Shqipëri. Une nuk kam nevojë të them me shumë, vetëm lexoni librin. Bëhem pjesë e historisë shqiptare. Shoh që përpjekjet e mia realizohen. N.q.s unë mund të jem një pjesë e vogël e historisë shqiptare, atëherë une do ta marr si angazhim përfshirjen me bashkëshortin në këtë histori. Faleminderit nga zemra dhe shpirti për këtë mbërme shumë të bukur. Përqafime dhe Zoti qoftë me ju”.

Librin “Marjana, historia shqiptare e një austriake”, lexuesit mund ta gjejnë në pikat e shitjes se librit në qytetin e Shkodrës.

Kozeta Bruçi

ADMINISTRIMI AUSTRO-HUNGAREZ I SHQIPËRISË 1916-1918

Është ky titulli i librit më të fundit, i cili sapo ka dalë nga botimi, dhe është promovuar ditën e merkurë, me datën 5 dhjetor 2018, në bibliotekën e universitetit "Luigj Gurakuqi" "Shkodër. Në promovimin e këtij libri disi të veçantë, i cili është botuar nën kujdesin e Konsullit të Nderit në Shkodër, Ambasades Austriake në Tiranë, merrnin pjesë autoritet vendore të Shkodrës, si kryetarja e Bashkisë Vulltana Ademi, kryetarja e këshillit të qarkut Greta Bardeli, pedagogje e intelektual të ndryshëm, si dhe dashamirë të austriakëve në qytetin e Shkodrës. Fillimisht në fjalën e tij konsulli i austriak në Shkodër Gjergj Leqejza, është ndalur tek rrugët që e çuan këtë liber të shikojnë dritën e botimit, po kështu ka folur edhe për rëndësinë e modelit të të mësuarit për të qeverisur nga shteti austriak. Më tej fjalën për të pershendetur këtë promovim e ka marrë ambasadori i Austriës në Tiranë, z. Johan Sattler, i cili me një shqipe të qartë ka treguar vlerat që sipas tij sjellë për lexuesin ky liber. Po kështu edhe ambasadori i kosovës në Tiranë ka shprehur mendimin e tij rreth fakteve historike që sillen në këtë liber. Nderkaq mjaftë studiues dhe historian me mendimet dhe studimet e tyre treguan dhe plotësuan gjithëcka pozitive që sjellë ky liber në shqip.

ipërisë nga trupat ushtarake austro-hungareze në vitet 1916-1918" është paqyrimi i ngjarjeve historike të vendit tonë në një periudhë historike, që ishte e pushtuar nga trupat austro-hungareze. Në atë kohë Shqipëria ende nuk kishte hyrë në fazën vendimtare të ndërtimit të institucioneve të saj dhe qeveritë shqiptare nuk kishin mundur akoma që të shtrinin sovranitetin e tyre të plotë në të gjithë territorin e përcaktuar nga Konferenca e Londrës 1912-1913

Libri është botuar në Vjenë në vitin 1918. Autor i tij është Prof. Dr. Mariano San Nicolo, aso kohe toger i ushtrisë perandorake dhe mbretërore të Austro-Hungarisë, dëshmitar i ngjarjeve dhe këshilltar e autor i hartimit të urdhërave dhe dekretëve të Komandës së Lartë Ushtarake të Ushtrisë Austro-Hungareze në Shqipëri. Përkthimi i këtij libri është iniciativë e Konsullatës së Austriës në Shkodër, në bashkëpunim me Ambasadën e Austriës dhe Institutin e Studimeve të Evropës Juglindore në Tiranë, nismë e cila u bë e mundur në saje të rekomandimit të Prof. Walter Hoflechner dhe këmbënguljes së Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, të cilët gjej rastin ti falënderoj shumë.

Autori San Nicolo na ka sjellë të dokumentuar përvojën më të përparuar evropi-

elementë të administrimit civil, të institucioneve të kohës përmes vendosjes së disa rregullave të përgjithshme me të cilat ushtrohen përgjegjësitë individuale dhe kolektive në Shqipëri duke u interesuar deri në detaje.

Vlerat e këtij libri janë disa dimensionesh. Mbi të gjitha autori bën një pasqyrë të modelit austriak të administrimit të shtetit në kohë lufte, model i cili ishte produkt i përvojës austro-hungareze të administrimit shtetëror në nivel qendror dhe lokal në kohë paqeje.

Së pari, lexuesi do të surprizohet për detajet e administrimit të punëve të shtetit

litete e zonat e administrimit austro-hungarez.

Së treti, si në çdo rast kur një vend është i pushtuar, edhe në rastin e pushtimit austro-hungarez të Shqipërisë në Luftën e Parë Botërore, urdhëratë e Komandës më të Lartë Ushtarake lidhen me qëllime të caktuara. Ajo që duket qartë në këto urdhra lidhur me sigurinë ka të bëjë me identifikimin e njerëzve, banorëve në zona e në qytete, me lëvizjen e tyre, me pajisjen me dokumente identifikimi, si karta identiteti, leje kalimi nga një rreth në tjetrin, nga Shqipëria në vendet fqinjë dhe në vendet të tjera, ose në Pe-



Dr. Johann Sattler, Ambasadori Republikës së Austriës në Tiranë, gjatë fjalës përshëndetëse



Zoti Gjergj Leqejza, Konsulli i Nderit në Shkodër, i Republikës së Austriës

FALA E PLOTË E Z. GJERGJ LEQEJZA, NË HAPJE TË PARAQITJES SË KËTIJ LIBRI

Jemi mbledhë sot për të promovuar, e jo vetëm, përkthimin e librit të prof. Dr. Mariano San Nicolo, projekt i zhvilluar në përmblyllje të vitit Kulturor Austri-Shqipëri "të rizbulojmë të përbashkëtat" që u realizua fale bashkëpunimit të Ambasadës së Republikës së Austriës e personalisht të Zotit Sattler, ambasador, Konsullatës së Nderit në Shkodër e Institutit të Studimeve për Evropën Juglindore dhe padyshim bashkëpunimit të përhershëm me Universitetin "Luigj Gurakuqi". Ky event do të shoqërohet dhe me një fotoekspozitë me foto e dokumente, shumica e të cilave të paeksponuara deri tash, e cila gjendet në hollin e Bashkisë Shkodër, ku një falënderim special i shkon Znj. Ademi, kryetare e Bashkisë.

Botimi i librit "Administrimi i Shq-

ane të qeverisjes, atë të Perandorisë Dualiste, natyrisht me disa specifika, të cilat i impononte situata e Luftës. Në libër jepen të gjitha urdhërat dhe dekretet, mbi bazën e të cilave kanë funksionuar komandat ushtarake, komunat e vendit, administrate qendrore dhe lokale, xhandarmëria dhe policia, gjykatat dhe prokuroria, arsimi dhe kultura, entet e kultit, tregtia dhe industria, bujqësia dhe peshkimi, shëndetësia, organet tatimore e doganore, marrëdhëniet me vendet fqinjë, raportet me Perandorinë Austro-Hungareze dhe vendet aleate të saj, si dhe me vendet asnjënjë të Luftës së Parë Botërore, që për nga struktura mund të thuhet pa frike. se është një manual perfekt ligje e urdhërash, se si duhet të funksionojë një shtet modern për kohën. Ato përbënin një eksperiencë të jashtëzakonshme për ndërtimin e shtetit shqiptar në të ardhmen.

Autori i këtij libri nuk merret me politikën e kohës, thjesht na transmeton modelin e funksionimit të shtetit në kushtet e pushtimit dhe administrimit ushtarak me

shqiptar në nivel lokal dhe qendror, për larinë e problematikave që janë parashtruar në dekretet e urdhra sa i përket këtij administrimi, për kujdesin që komanda ushtarake pushtuese tregon sa i përket zhvillimit dhe përparimit të ekonomisë, kulturës, punëve të ndërtimit e projekteve të zhvillimit në Shqipëri. Ndonëse pushtuesit përdorin çdo mundësi të përçajnë faktorët e brendshëm të vendit të pushtuar, libri na kujton se me forcat pushtuese austro-hungareze ndodhi e kundërta.

Së dyti, në këtë libër bëjnë përshtypje detajet e planifikimit të çështjeve të administrimit civil e ushtarak në Shqipëri, të parashikuara në dekretet dhe urdhëratë e Komandës së Lartë Ushtarake të Ushtrisë Austro-hungareze të kësaj periudhe historike. Lexuesi do të njihet me urdhra e dekretet që lidhen me veprimtarinë e administrimit civil dhe ushtarak në Shqipëri. Aty gjenden detaje për organizimin e sistemit civil në komuna, rrethe, loka-

randorinë Austro-Hungareze. Në këtë aspekt urdhëratë dhe udhëzimet që përmbledh ky libër shprehin përveç principeve themelore të normave dhe rregullave të caktuara, edhe ashpërsinë e dënimeve dhe dinamikën e raporteve midis ushtrisë dhe institucioneve të administrimit austriak e vendor me faktorët e tjerë në komuna e zonat e pushtuara.

Së katërti, është për t'u vlerësuar fakti se, megjithëse në kushtet e luftës, në shumën e urdhrave vërehet porosia dhe kujdesi për të bërë drejtësi, për të qene human, për të respektuar traditat dhe zakonet e kulturës dhe ato fetare të shqiptarëve, për të mos dënuar njerëz të pafajshëm, për të dëmshpërblyer ata, të cilët fitojnë pafajësinë. Ashpërsia e ndëshkimeve dhe dënimeve është tipar i këtij administrimi. Gjakkarrja ishte shqetësim i jashtëzakonshëm për institucionet ushtarake e civile të kohës. Për këtë qëllim u organizua një fushatë pajtimi mbarëkombëtare, ndërkohë që u shpall urdhri që

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi

JAM...!

Me të sëmurin që dergjet anës shtratit
 Me të larguarin që endet rrugëve te fatit
 Me nënën që digjet nga malli për birin
 Jam dhe me të keqin siç jam me të mirin
 Jam me vogëlushin që thurret atin në gjumë
 Me mikun e mërziur që dot spo gjen punë...
 Jam me lypsin që kërkon lëmoshe çdo ditë
 Me të verbrin që se di a është nate a dite
 Me të shurdhin që sdegoj kurre një "të dua"
 Me vashen që u vyshk, e kurrë s'u martua
 Me bujkun që vapa, ja thau buzën për ujë
 Me djalin që pret vajzen, mallin t' ja shuajë
 Me çobanin që pret të ktheje bagëtitë në stan
 Me motren që e dogji malli për vëllanë
 Me lulen që çeli e si mori kush erë
 Me ata që se priten dot dhe ketë verë
 Jam dallge e stuhi në të acartat çaste
 Puhize maji, si prekja e buzës në faqe
 Qetesi liqeni në të bekuaren verë
 Aromë lule bjeshke, që s'mbaron asnjëhere
 Jam agu i mëngjesit, kur dielli të puth sytë
 Perëndim i arte, që flakëron si yjtë
 Jam flokëz bore që bie pa u ndjere
 Rrebesh shiu vere që prish çdo të mbjelle
 Jam heshtje që ulëras më shume se njëmije zëra
 Ortek bore mali që merr ç'të zëre perpara
 Rrënje lisi që kapem me kthetra pas jetës
 Dashuri që smbaron, idhtare e së vërtetës
 Jam grua...jam nënë ...jam bijë e motër
 Vëlla më quajti vëllai tërë jetën në votër
 Jam femër... krenare sa bjeshka që më rriti
 Jam Përjetësi, që dhe pas vdekjes do i flasë shpirti...!

Ku ke shku bylbyl?

I amlu zog, ku ke shku me bujt
 Qe kohe kam pa te ni at za?
 Ner malet tona atje ku kam lind
 Shpesh jam kan msu me t'pa.

A noshta idhnu ju ke njerzve
 Qe iken e s'pat kush me t'livdue
 A pylli si vendi ku isha dhe une
 I vorfen, i ftohte asht shnderrue.

A noshta zbeh ngjyrat tu kan edhe ty
 Si zbeh shpirti na asht edhe ne
 A s'pat kush me t'dhane ni dore zog i bukur?
 Me nertu te amblen fole.

A e di zog i dashtun, sa shume ngjajma na sot
 Humb e tret se di qe sa mote
 A thu malit e venit ku u lindem une e ti
 I mungon hapi jem ... kanga jote?

A thu nry n'kafaz noj i pashpirt te ka
 se s'ka dit ku je rrit e ke verue?
 A thu zemren lendu kush ta ka
 sikur jeta ma ka lendue mue..?

Ku ke humb zog i dashtun, pash hatrin e Zotit?
 M'çto nji shenje ku ke mbet,ka ke shkue
 E ne e gjetsh udhen me u kthye ndonjëhere
 Mos harro çoma i fjale edhe mue.

Shkojme atje ku noshta ma s'kem me gjet
 as fole as strehe ma ndertue
 Ulna n'gur, aty ku kush nuk na thote
 çohnu pak, vend te huj keni zaptue.

E s'ka dert vec te jena n'vandin tone
 E tan hallet e ksaj bote ti harrojme
 vec t'na nijne zanin bjeshket tone
 S'ka me dit a po knojme a po vajtojme...

Kthehu bylbyl....!

Portë e vjetër!

Në derë kishte mbet një dry i vjetër.
 Që i Zoti i shtëpisë për ta kyçur kishte bërë orë
 Kushedi ai ndryshk nga lotët qe shkaktuar
 Kushedi si i është dridhur e bekuara dorë
 Sa mall e kujtime do të ketë lënë brenda
 Ndaj ai dry i portës u mbyll aq me zori
 Kushedi në sa copa ju ka ndarë zemra
 Kushedi sa la e sa me vete mori
 Pashë flutura që qanin, e lule s'pashë gjekundi
 Shkreti ish bërë rrethina, zhuritur prej mungesës
 Diku nje dry i mbyllur qëndronte në derë varur
 Mbirë kishte një jetë ... mes vdekjes edhe Shpresës!

Ti je e falur...!

Ndër ëndrra më the më erdhi një zanë
 Ma prishi gjumin, por se fajësova
 Më heshti buza nuk nxora zë
 Ç'donte nga unë?Unë nuk e ftova

A thua mësuar është të endet
 Ndër mendje burrash të sjellë trazime

Ç'deshi kjo grua që erdhi sonte?
 Më zgjoj dhe iku ndër mjegullime

A më tregon moj mike bukur
 Ç'emër ti vë,si të ja them
 Do të mendojë që qenkam çmendur
 Unë miku i saj qe mirë më njeh

Ajo ska faj,kushedi unë
 Për ndonjë çast e kam menduar
 Nuk mbaj mend ta kem thënë me zë
 Kushedi ëndrrës ja kam treguar

Ajo ska faj, kushedi unë
 Për ndonjë çast e kam menduar
 Nuk mbaj mend ta kem thënë me zë
 Kushedi ëndrrës ja kam treguar

Heshta për pak sa e dëgjova
 Kush ishte?-e pyeta pa u menduar
 Ti je e falur!-belbëzoj ndër dhëmbë
 Të pathënat fjalë mi la ndër duar!

Poetja Bona
 Mulaj Lluka



shkelësit e fjalës së dhënë për pajtimin e gjaqeve të dënoheshin me varje. Organizimi I fushatës së faljes së gjaqeve e kombinuar me masa shtrënguese, është fenomen i ri në formën e angazhimit të institucioneve të shtetit në Shqipëri. Të vetëdijshëm se sukcesi i administrimit varet nga ushtrimi i drejtësisë pa dallim dhe pa diskriminim, autoritetet ushtarake dhe civile të Perandorisë Dualiste i dhanë administrimit të tyre në Shqipëri tiparin e një qeverisjeje bazuar në shtetin ligjor të së drejtës.

Nëse do t'i hynim një analize të hollesishme te të gjithë elementëve që shprehin ligjet, dekretet dhe urdhëratë e kësaj

periudhe të pushtimit austro-hungarez të Shqipërisë, atëherë do të mund të gjenim me dhjetëra e ndoshta qindra element pozitivë në to. Por përmendim këto karakteristika e tipare të lartë cituara thjesht për t'i dhënë lexuesit një panoramë të shkurtër të asaj se çfarë përfaqëson ky libër.

Është unikale në historinë e pushtimeve në botë, kur një "pushtues" si ushtria e Monarkisë Dualiste të kujdeset edhe për rritjen e ndjenjës kombëtare, edhe për arsimimin vetëm në gjuhën shqipe dhe mbylljen e shkollave në gjuhë italiane dhe greke, për emancipimin e shqiptarëve, duke ruajtur identitetin kombëtar të tyre.

Këto dhe risi të tjera lexuesi i gjen në çdo kapitull të këtij libri model. Dhe për këtë lexuesit e sotëm duhet t'i falënderohen autorit Prof. Dr. Mariano San Nicolo.

Mendoj se çdo kush, që do ta lexojë këtë libër, veçmas juristët dhe studentët e juridikut, por dhe historianët, studentët e pedagogët e administrimit e të shkencave politike, si dhe të tjerë të interesuar, do të shpërblehen me një thesar në fushën e jurisprudencës, të rregullit, të shtetndërtimit e funksionimit të institucioneve.

Duke ju falënderuar për zemërsisht për pjesëmarrjen, jam i bindur se lektorët e nderuar do te flasin, komentojnë e plotësojnë ne mënyre profesionale për-

bajtjen e këtij libri mjaft interesant e të vlefshëm i cili nga sot do te jete ne dispozicion e vlerësim te lexuesit.

Së fundi, por aspak për nga rëndësia, gjej rastin të falënderoj ato që bënë të mundur përkthimin e këtij libri, Energji Ashta gjithnjë pranë e vlefshme në veprimtari të këtij lloji; Ambasadën e Republikës së Austrisë e veçanërisht zotin Ambasador Sattler, Bashkinë Shkodër e Universitetin "Luigi Gurakuqi"!

Duke ju falënderuar për zemërsisht për prezencën e vëmendjen uroj qëndrimin te këndshëm e sukses ne aktivitetet e sotme.

Ju faleminderit!

Redaksia

REDAKSIA

Kryeredaktor: Suela Ndoja

Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

**GËZIM KOLË
 ÇARDAKU**

